



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

PROGRAMI KOMBËTAR I VAKSINIMIT

PROCESI I VAKSINIMIT NDAJ COVID-19 DHE GRIPIT SEZONAL

JAVA 3, 2026

Permbajtja:

1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026 (java 3, 2026)
2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 3, 2026)

1. VAKSINIMI NDAJ GRIPIT SEZONAL 2025-2026

Vaksinimi ndaj gripit sezonal është një masë parandaluese e rëndësishme për reduktimin e shtrimeve në spitale, komplikacioneve dhe vdekjeve të shkaktuara nga viruset respiratorë, veçanërisht tek personat me sëmundje bashkëshoqëruese.

Në Shqipëri, në vitin 2007 u hartuan politikat e para për vaksinimin ndaj gripit sezonal për grupet e riskut, të cilat përfshinin personat me sëmundje kronike dhe personelin shëndetësor. Në vijim, në vitin 2009, u bënë ndryshime në politikat e vaksinimit ndaj gripit sezonal për grupet e riskut, duke përfshirë:

- Të moshuarit
- Personat me sëmundje kronike
- Personelin shëndetësor
- Gratë shtatzëna

Në vitin 2014 u bënë ndryshime të tjera në politikat e vaksinimit ndaj gripit për grupet e riskut, ku krahas të moshuarve, personave me sëmundje kronike dhe grave shtatzëna, u shtuan edhe fëmijët dhe personat obezë, si dhe u specifikua personeli shëndetësor target.

Në vitin 2016 u kryen modifikime të tjera në politikat e vaksinimit ndaj gripit, me rekomandimin për vaksinimin e të gjithë personave nga mosha 6 muaj e lart, duke u fokusuar veçanërisht tek grupet e riskut: fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit, personat me sëmundje kronike, personat obezë dhe personeli shëndetësor target.

Në vitin 2017 dhe në vijim, në rekomandimet e vaksinimit u shtuan edhe personat me diabet, si dhe u përfshi i gjithë personeli shëndetësor. Një program i posaçëm vaksinimi për punonjësit e kujdesit shëndetësor ishte krijuar që në vitin 2014.


Që nga viti 2018, vaksina e gripit është përfshirë në planin dhe parashikimin kombëtar të imunizimit. Buxheti për vaksinën e gripit është përfshirë në linjën buxhetore të vaksinave të fëmijëve, në kuadër të Programit Kombëtar të Vaksinimit.

Tashmë, vaksinimi ndaj gripit sezonal kryhet prej shumë vitesh dhe vazhdon të rekomandohet për personat në risk, të cilët përfshijnë:

- Punonjësit shëndetësorë (mjekë, infermierë, staf mbështetës)

- Persona me sëmundje kardiovaskulare, diabet, sëmundje pulmonare dhe sëmundje të tjera kronike të mëlçisë ose veshkave, si dhe persona me tumor/kancer
- Persona obezë
- Persona me imunitet të komprometuar
- Gra shtatzëna
- Persona mbi 65 vjeç
- Mësues dhe edukatorë
- Policë dhe forcat e rendit
- Fëmijë nga 6 muaj deri në 12 vjeç

Sasia e dozave të prokuruar ndë vite ka ardhur në rritje. Në grafik paraqiten dozat e blera nga Qeveria Shqiptare, donacionet, si dhe vaksinat e blera nga firmat farmaceutike ndë vite.



Grafiku 1: Sasia e vaksinave te gripit te ardhura ndë vite

- Gjatë sezonit të gripit **2025-2026** Programi Kombëtar i Vaksinit, pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) ka shpërndare në 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) **280,000 doza të vaksinës ndaj gripit sezonal**, përkatësisht: 40,000 doza në flakon një-dozësh dhe 240,000 doza në flakon me 10 doza. Vaksinimi ndaj gripit sezonal për sezonin **2025–2026** nisi më **22 shtator 2025** në të gjithë vendin.
- Gjatë sezonit **2024-2025**, kanë ardhur **280 000** doza vaksinë gripi, 4 valente (40 000 doza në flakon me një dozë dhe 240 000 doza në flakon me 10 doza) dhe fushata e vaksinit ndaj gripit sezonal 2024-2025 filloi në datën **7 Tetor 2024** në të gjithë vendin.
- Gjatë sezonit **2023-2024** kanë ardhur **260 000 doza** vaksine gripi, 4 valente dhe fushata e vaksinit kundër gripit sezonal 2023-2024 filloi në datën **16 Tetor 2023** në të gjithë vendin.

Llojet e vaksinave të përdorura


- Gjatë këtyre sezoneve, në Shqipëri janë aplikuar **vaksinat 4-valente** me virion te copëzuar, te inaktivizuara, GC FLU të prodhuara nga GC Biopharma në Korenë e Jugut dhe të parakualifikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) **të cilat janë në flakone** prej 0.5ml dhe aplikohen në mënyre intramuskulare.

Ecuria e vaksinit:

Aplikimi dhe regjistrimi në SIV i vaksinave ndaj gripit sezonal ka filluar gjatë sezonit 2023-2024 dhe në vazhdim ndaj të dhënat janë marrë nga sistemi.

- Për sezonin 2025-2026 deri në javën 3/2026 (22 Shtator – 18 Janar) janë kryer gjithsej 239 585 doza, që përbëjnë 85.5 % të dozave të shpërndara.
- Për sezonin 2024-2025 deri deri në javën 3/2025 (7 tetor – 19 janar) janë kryer gjithsej 216 444 që përbëjnë 77.3 % të dozave të shpërndara.
- Për sezonin 2023-2024 deri deri në javën 3/2024 (16 tetor – 21 janar) janë kryer gjithsej 208 711 që përbëjnë 80.2 % të dozave të shpërndara.

Ecuria e vaksinit deri në javën e 3-të për 3 sezonet e gripit të sipërpërmendura paraqiten në grafikun mëposhtë. Dhe në grafik tregohet që në 3 sezonet e gripit sezonal javët e para kanë dhe numrin më të lartë të aplikimit të vaksinave dhe më pas ka një rënie graduale.



Grafiku 2: Ecuria e vaksinimit sipas javëve për 3 sezone të gripit sezonal


Shpërndarja e dozave dhe të aplikuarra sipas NJVKSH-ve për sezonin 2025-2026 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

		Sasia ne doza	Sasia e shperndare (GC Flu 1/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 1/doze)	% e aplikimit (GC Flu 1/doze)	Sasia e shperndare (GC Flu 10/doze)	Sasia e aplikuar me (GC Flu 10/doze)	% e aplikimit (GC Flu 10/doze)	TOTAL	% e aplikimit ne total
	NJVKSH									
Shkodër	Shkodër	14000	1000	748	74.8	13000	9971	76.70	10719	76.56
	Malësi e Madhe	3500	500	397	79.4	3000	2949	98.30	3346	95.60
	Pukë	2500	500	315	63.0	2000	1934	96.70	2249	89.96
Kukës	Kukës	4000	500	487	97.4	3500	3405	97.29	3892	97.30
	Has	1500	500	498	99.6	1000	1000	100.00	1498	99.87
	Tropojë	2000	500	487	97.4	1500	1357	90.47	1844	92.20
Lezhë	Lezhë	6000	500	480	96.0	5500	5495	99.91	5975	99.58
	Mirditë	2500	500	497	99.4	2000	1994	99.70	2491	99.64
	Kurbin	4500	500	500	100.0	4000	3376	84.40	3876	86.13
Tiranë	Tiranë	36000	6000	4736	78.9	30000	25854	86.18	30590	84.97
	Kavaje	7000	1000	741	74.1	6000	4685	78.08	5426	77.51
Durrës	Durrës	17000	3000	2146	71.5	14000	11672	83.37	13818	81.28
	Krujë	6000	1000	585	58.5	5000	4333	86.66	4918	81.97
Dibër	Dibër	6000	1000	890	89.0	5000	4840	96.80	5730	95.50
	Bulqizë	3500	500	390	78.0	3000	2042	68.07	2432	69.49
Fier	Mat	3800	800	477	59.6	3000	2231	74.37	2708	71.26
	Fier	27600	2600	2558	98.4	25000	25001	100.00	27559	99.85
	Mallakastër	2900	400	400	100.0	2500	2417	96.68	2817	97.14
Vlorë	Lushnjë	22000	2000	1700	85.0	20000	13821	69.11	15521	70.55
	Vlorë	18500	1500	1454	96.9	17000	14210	83.59	15664	84.67
	Delvinë	3450	450	413	91.8	3000	1484	49.47	1897	54.99
Gjirokastrë	Sarandë	4800	800	682	85.3	4000	3630	90.75	4312	89.83
	Gjirokastrë	7500	1000	762	76.2	6500	5481	84.32	6243	83.24
	Përmet	3450	450	294	65.3	3000	2721	90.70	3015	87.39
	Tepelenë	3000	500	461	92.2	2500	2116	84.64	2577	85.90
Korçë	Korçë	11000	1000	964	96.4	10000	9562	95.62	10526	95.69
	Pogradec	6330	830	737	88.8	5500	5191	94.38	5928	93.65
	Devoll	2500	500	460	92.0	2000	1934	96.70	2394	95.76
	Kolonjë	1500	500	447	89.4	1000	930	93.00	1377	91.80
Berat	Berat	11000	1000	825	82.5	10000	9549	95.49	10374	94.31
	Kuçovë	3500	500	496	99.2	3000	2911	97.03	3407	97.34
	Skrapar	3500	500	500	100.0	3000	3000	100.00	3500	100.00
Elbasan	Elbasan	16000	4000	3544	88.6	12000	7331	61.09	10875	67.97
	Peqin	3000	500	356	71.2	2500	2130	85.20	2486	82.87
	Gramsh	3500	500	494	98.8	3000	3000	100.00	3494	99.83
	Librazhd	3500	500	314	62.8	3000	2244	74.80	2558	73.09
Total		278330	38330	32235		240000	205801		238036	85.52

Tabela 1: Sasia e dozave te shpërndara dhe përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, java 3/2026


Ecuria e procesit te vaksinimit sipas katër rajoneve të vendit

DROSHKSH Tiranë: përfshin NJVKSH Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Krujë, Tiranë dhe Kavajë. NJVKSH-të me përdorimin më të lartë dhe konstant për 3 sezonet janë NJVKSH Dibër me mbi 90 % dhe NJVKSH Durrës mbi 80 %. Njvksh Krujë ka një rritje të përdorimit nga sezoni 2024-2025 (49.4%) në (82%) dhe gjithashtu NJVKSH Tiranë ka një përdorim më të mirë (85.3 %) gjatë sezonit 2025-2026. Përdorimi i vaksinës në përqindje për këtë rajon paraqitet në grafikun e mëposhtëm.




Grafiku 3: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Tiranë

DROSHKSH Shkodër: përfshin NJVKSH Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe. Ky rajon në sezonin 2025-2026 ka patur një rritje të dukshme të aplikimit të vaksinës kryesisht në NJVKSH Has (99.9 %), NJVKSH Mirditë (99.6%), NJVKSH Lezhë (99.6 %), NJVKSH M.Madhe (95.6 %), NJVKSH Pukë (90 %), NJVKSH Kurbin (86.6%), NJVKSH SHkodër (76.6 %).




Grafiku 4: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Shkodër

DROSHKSH Elbasan: përfshin NJVKSH Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Berat, Kuçovë, Skrapar, Elbasan, Peqin, Gramsh dhe Librazhd. Ky rajon ka patur në përgjithësi një ecure të mirë vaksinimi por ato që në sezonin e fundit kanë përqindje më të lartë janë Njvksh Skrapar që ka arritur 100 % të përdorimit, NJVKSH Gramsh (99.8 %), NJVKSH Kuçovë (97.3 %), Njvksh Korçë (95.7 %), NJVKSH Devoll (95.8 %), Njvksh Pogradec (94.5 %), NJVKSH Kolonjë (91.9%). Njvksh Elbasan ka patur një ecure të ngadaltë me përqindjen më të ulët (68.3 %) në sezonin 2025-2026.



Grafiku 5: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Elbasan


DROSHKSH Vlorë: përfshin NJVKSH Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë. Njvksh Fier në 3 sezone ka patur një përqindje të lartë vaksinimi me mbi (95 %). Disa Njvksh kanë një rritje të lartë të përdorimit si NJVKSH Mallakastër (97.1%), NJVKSH Përmet (87.6 %), Njvksh Tepelenë (85.9 %). Njvksh Gjirokastrë ka patur një ulje nga 100 % në sezonin 2023-2024 në (83.5 %) për sezonin 2025-2026. Njvksh Delvinë ka përqindjen më të ulët të përdorimit në 3 sezone (54.9 %).



Grafiku 6: Përqindja e aplikimit sipas NJVKSH-ve, DROSHKSH Vlorë

Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave


Grafiku mëposhtëm paraqet mbulesën vaksinale sipas grupmoshave për tre sezonet e gripit. Grupmosha me mbulesën më të lartë vaksinale në te treja sezonet është grup mosha mbi 80 vjeç përkatësisht në sezonin 2025-2026 (31.5 %), për sezonin 2024-2025 (28%) dhe në sezonin 2023-2024 (24.8 %).



Grafiku 7: Mbulesa vaksinale sipas grup-moshave për 3 sezone të gripit sezonal

Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut


Grafiku paraqet mbulesën vaksinale sipas grupeve të riskut dhe mbulesa vaksinale në të 3 sezonet e gripit sezonal është më e lartë është tek personat me sëmundje kardiovaskulare mbi (35 %). Të dhënat e popullatës me sëmundje kronike janë marrë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (**FSDKSH**).



Grafiku 8: Mbulesa vaksinale sipas grupeve të riskut, tre sezone të gripit sezonal

Mbulesa vaksinale tek personeli shëndetësor


Stafi mjekësor është ndër grupet më të ekspozuara ndaj gripit sezonal për shkak të kontaktit të vazhdueshëm me pacientët dhe ekspozimit të lartë ndaj infeksioneve respiratore. Në dy sezonet e mëparshme mbulesa vaksinale ka qënë më e ulët tek personeli shëndetësor ndersa në sezonin aktual 2025-2026 mbulesa vaksinale është 51.9 %.



Grafiku 9: Mbulesa vaksinale sipas personelit shëndetësor

Aplikimi i vaksinës sipas profesioneve

Gjatë tre sezoneve të gripit sezonal mësuesit janë ato me numrin më të lartë të aplikimit të vaksinës ndaj gripit sezonal. Numrin më të ulët të aplikimeve e kanë edukatorët.



Grafiku 10: Aplikimi i vaksinës sipas profesioneve, tre sezonet e gripit sezonal

2. VAKSINIMI NDAJ COVID-19 (Java 43, 2024-java 3, 2026)

Në mbledhjen e datës 22 gusht 2024, Komiteti Shqiptar i Ekspertëve të Vaksinimit (NITAG) rekomandoi:

1. Vaksinimi ndaj COVID-19 duhet të vazhdojë.
2. Çdo vit duhet të aplikohet vaksina ndaj COVID-19 për grupet më prioritare dhe në rrezik.
3. Vaksina COVID-19 duhet të administrohet në të njëjtën kohë me vaksinën kundër gripit sezonal, kur është e mundur, për të shmangur që qytetarët të paraqiten dy herë në qendrat shëndetësore.
4. Të vaksinohen me një dozë të vaksinës monovalente, pavarësisht nga statusi i mëparshëm i vaksinimit, personat në grupet e mëposhtme:
 - Punonjësit shëndetësorë dhe ata që punojnë në institucione të kujdesit afatgjatë.
 - Personat që jetojnë në institucione të kujdesit afatgjatë (mbi 12 vjeç).
 - Të gjithë personat mbi 60 vjeç.
 - Personat mbi 12 vjeç me sëmundje bashkëshoqëruese, përfshirë:
 - Sëmundje kardiovaskulare.
 - Diabet.
 - Sëmundje obstruktive të mushkërive.

- Sëmundje kronike të veshkave dhe mëlçisë.
 - Lloje të ndryshme kanceri.
 - Gjendje që shkaktojnë frenim të imunitetit.
 - Obezitet.
- Gratë shtatzëna.

Vaksina COMIRNATY™ e Disponueshme në Shqipëri:

Aktualisht në Shqipëri është e disponueshme vakcina **COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]**

COMIRNATY™ Monovalent [Omicron JN.1]


- **Përmbajtje aktive:** *bretovameran* (mRNA për nënvariantin Omicron JN.1)
- **Përdorimi:** 30 mikrogramë për adoleshentë dhe të rritur ≥ 12 vjeç
- **Data e skadencës së dozave të ardhura:** 31 mars 2026
- **Sasia e ardhur më 17 prill 2025:** 5,760 doza

Dokumentimi i Vaksinimit

Çdo vaksinë e administruar regjistrohet **në kohë reale në Sistemin e Informimit të Vaksinimit (SIV)** dhe është e disponueshme për qytetarët në **portalin e-Albania**, te seksioni “**Kartela ime e Vaksinimit**”.

Kartela ofrohet në **shqip dhe anglisht** dhe është e vlefshme për përdorim personal apo zyrtar.


Nga fillimi i përdorimit në javën e 43-të të vitit 2024 deri në javën e 3-të të vitit 2026, në Shqipëri janë administruar gjithsej **1,689 doza**.



Grafiku 1. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 të aplikuara sipas javëve, (java 43, 2024-java 3, 2026)

Grafiku paraqet numrin e vaksinave COVID-19 të aplikuara sipas javëve, për periudhën 2024–2025-2026.


Megjithëse rekomandohet aplikimi i vaksinës kundër COVID-19, vihet re një ulje e kërkesës nga qytetarët dhe, si pasojë, edhe e numrit të vaksinave të administruara.



Grafiku 2. Numri i vaksinave ndaj COVID-19 të aplikuara sipas NJVKSH-ve (java 43, 2024-java 3, 2026)

Sic shihet në grafik **Tirana** ka numrin më të lartë të vaksinave (531), ndjekur nga **Fieri** (209) dhe **Vlora** (142).


Stafi mjekësor përbën një nga grupet me risk të lartë për ekspozim ndaj infeksionit me COVID-19, për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me pacientët dhe mjediset shëndetësore. Vaksinimi i këtij grupi është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre personal, por edhe për të garantuar sigurinë e pacientëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë, të dhënat tregojnë se përdorimi i vaksinës në këtë kategori mbetet i ulët. Ne total janë aplikuar **115 doza** deri javën e 3, 2026.



Grafiku 3: Numri i stafit mjeksor te vaksinuar ndaj COVID-19, (java 43, 2024-java 3 2026)

Infermierët kanë numrin më të madh të vaksinimeve (77), ndjekur nga **mjekët** me (29). **Stafi mbështetës** ka marrë **9 doza**. **Totali i përgjithshëm është 115**, duke reflektuar numrin e përgjithshëm të vaksinimeve në këtë kategori profesionale.


Grupet në rrezik për komplikacione të rënda nga COVID-19 përfshijnë të moshuarit, personat me sëmundje kronike (si diabet, hipertension, sëmundje kardiovaskulare, respiratore, renale dhe hepatike), individët me imunitet të kompromentuar, gratë shtatzëna, si dhe punonjësit shëndetësorë. Vaksinimi i këtyre grupeve është një masë thelbësore parandaluese për të reduktuar shtrimet në spitale, format e rënda të sëmundjes dhe rrezikun e vdekshmërisë. Për më tepër, mbrojtja e këtyre kategorive ka ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e kapaciteteve të sistemit shëndetësor dhe në sigurimin e funksionimit normal të shërbimeve të tjera mjekësore. Rekomandimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare theksojnë rëndësinë e vaksinimit periodik për këto grupe, duke pasur parasysh se imuniteti i fituar nga vaksina apo infeksioni i mëparshëm zbehet me kalimin e kohës.



Grafiku 1: Numri I personave te vaksinuar ndaj COVID-19 sipas grupeve te riskut, (java 43, 2024-java 3, 2026)

Vaksinimi ndaj COVID-19 sipas grupmoshave

Vaksinimi kundër COVID-19 mbetet një ndër masat kryesore për parandalimin e formave të rënda të sëmundjes dhe uljen e numrit të shtrimeve në spitale. Efektiviteti dhe rëndësia e vaksinimit ndryshon sipas grupmoshave, duke reflektuar nivelin e rrezikut që secila kategori paraqet. Grupmosha **25–39 vjeç** ka numrin më të lartë të vaksinimeve (472). Pas saj renditen grupmoshat **50–59 vjeç (326)** dhe **60–69 vjeç (313)**. Grupmoshat më të reja (12–17 vjeç) dhe më të moshuarit mbi 80 vjeç kanë numrat më të ulët të vaksinimit.



Grafiku 2: Numri i vaksinave ndaj COVID-19 te aplikuara sipas grup-moshave, (java 43, 2024-java 3, 2026)

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK